



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSINA
SKENDERAJ

Nr. 02-112/07-0054323/25

Data
26.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

PLANI I PUNËS I EKZEKUTIVIT PËR VITIN 2026

Skenderaj, Dhjetor 2025

Përmbajtja:

Fjala e Kryetarit.....	2
Hyrje.....	3
Zyra për Informim.....	4
Plani vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.....	8
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.....	10
Zyra Ligjore.....	10
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.....	10
Drejtoria për Administratë.....	11
Drejtoria për Buxhet dhe Financa.....	12
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm.....	18
Drejtoria e Prokurimit Publik.....	20
Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.....	22
Drejtoria për Urbanizëm.....	23
Drejtoria për Kulturë Rimi dhe Sport.....	25
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	27
Drejtoria e Shërbimeve Publike.....	30
Drejtoria e Inspektoratit.....	35
Drejtoria Komunale e Arsimit.....	37
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.....	41

Fjala e Kryetarit

Të nderuar qytetarë të Komunës së Skenderajt,

Plani Vjetor i Punës së Ekzekutivit për vitin 2026 pasqyron vizionin, përkushtimin dhe përgjegjësinë tonë të përbashkët për të ardhmen e Komunës së Skenderajt. Ky plan paraqet orientimin tonë për vitin 2026, drejt një zhvillimi të qëndrueshëm, përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve publike dhe forcimit të transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Angazhimi im për Skenderajn ka qenë dhe mbetet i pandryshueshëm: të kontribuoj për ndryshimin dhe zhvillimin e Skenderajt, qytetit tonë, vendit tonë, të cilin me shumë mund, sakrificë dhe përkushtim e ndërtuam nga gërmadhat, duke e shndërruar gradualisht në një qytet model.

Plani për vitin 2026 është ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe mbi bazën e nevojave reale dhe prioriteteve të qytetarëve tanë. Ai synon vazhdimin e investimeve në infrastrukturë, arsimit, shëndetësi, mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit, duke garantuar barazi, përfshirje dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

Angazhimi im personal dhe institucional mbetet i palëkundur që Komuna e Skenderajt të vazhdojë të zhvillohet si një komunë e fortë, funksionale dhe me perspektivë të qartë për brezat e ardhshëm.

Me besim në të ardhmen dhe me respekt të thellë për sakrificën e së kaluarës, do të vazhdojmë së bashku rrugën e ndërtimit dhe zhvillimit të qytetit tonë.

Kryetari i Komunës:

Sami Lushniku

Hyrje

Plani Vjetor i Punës së Ekzekutivit për vitin 2026 paraqet dokumentin udhëzues për funksionimin dhe veprimtarinë e organeve ekzekutive të Komunës së Skenderajt. Ky plan përcakton objektivat, aktivitetet dhe përgjegjësitë e drejtorive komunale, me qëllim të zbatimit efektiv të politikave komunale, përmirësimit të shërbimeve publike dhe avancimit të zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Dokumenti shërben si bazë për koordinimin e punës ndërmjet drejtorive dhe për orientimin e veprimeve të ekzekutivit gjatë vitit 2026.

Plani Vjetor i Punës është hartuar në përputhje me kornizën ligjore dhe institucionale në fuqi, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Statutin e Komunës së Skenderajt, si dhe në strategjitë dhe planet sektoriale komunale. Këto dokumente përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë dhe parimet mbi të cilat bazohet veprimtaria e ekzekutivit komunal.

Gjatë vitit 2026, Ekzekutivi Komunal synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes së iniciativave zhvillimore dhe ndërmarrësisë. Një rëndësi e veçantë i kushtohet investimeve në infrastrukturën publike, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së qytetarëve, si dhe përkrahjes së sektorëve kyç si arsimi, shëndetësia dhe mirëqenia sociale.

Në kuadër të zbatimit të këtij plani, secila drejtori komunale do të zbatojë planin e saj vjetor, në përputhje me objektivat e përgjithshme të Ekzekutivit Komunal. Këto plane do të përcaktojnë aktivitetet konkrete, afatet kohore të realizimit dhe indikatorët e performancës, duke mundësuar monitorimin e vazhdueshëm të progresit dhe vlerësimin e rezultateve të arritura gjatë vitit 2026.

Zyra për Informim

Qëllimi i planit vjetor të punës së Zyrës për Informim për vitin 2026 është të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar të aktiviteve, shërbimeve dhe angazhimeve që kjo zyrë do të realizojë gjatë vitit. Plani synon të sigurojë informim të rregullt, transparent dhe në kohë për qytetarët lidhur me veprimtarinë e komunës.

Në kuadër të këtij plani përfshihen: publikimi i lajmeve, njoftimeve zyrtare, thirrjeve publike, anketave, konkurseve si dhe aktiviteteve të tjera komunale, të cilat do të shpërndahen përmes faqes zyrtare të komunës dhe rrjeteve sociale.

Ky plan ka karakter orientues dhe mund të pësojë ndryshime gjatë zbatimit, në varësi të nevojave institucionale dhe zhvillimeve që paraqiten gjatë vitit 2026, duke përfshirë edhe publikimin e informatave shtesë në interes të publikut.

Tabela e aktiviteteve:

Janar	<ol style="list-style-type: none">1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal.2. Publikimi i raportit të punës të Ekzekutivit për vitin 2025.3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike.4. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, KKS-së dhe Komitetit për Komunitete.5. Publikimi i raporteve financiare për vitin 2025.6. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit dhe raporteve të tyre.7. Publikimi i raportit për qasje në dokumente publike.8. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve.9. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera.10. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal.11. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Shkurt	<ol style="list-style-type: none">1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal.2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike.3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, dhe Komitetit për Komunitete.4. Publikimi i agjendës për aktivitetet që shënojnë 17 Shkurtin - Ditën e Pavarësisë së Kosovës.5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit.

	<ol style="list-style-type: none"> 6. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 7. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandevë dhe dokumenteve të tjera. 8. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 9. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Mars	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, KKS-së dhe Komitetit për Komunitete. 4. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 5. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 6. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandevë dhe dokumenteve të tjera. 7. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 8. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Prill	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së dhe Komitetit për Komunitete. 4. Publikimi i raportit tremujor financiar për vitin 2026. 5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 6. Publikimi i raportit tremujor për qasje në dokumente publike. 7. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 8. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandevë dhe dokumenteve të tjera. 9. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 10. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Maj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, KKS-së dhe Komitetit për Komunitete. 4. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 5. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 6. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandevë dhe dokumenteve të tjera. 7. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 8. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.

Qershor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Publikimi i njoftimit për mbajtjen e takimit të parë me publikun të Kryetarit të Komunës. 3. Publikimi i agjendës për aktivitetet që shënojnë 18 Qershorin – Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Skenderajt. 4. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore për KAB. 5. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së dhe Komitetit për Komunitete. 6. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 7. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 8. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera. 9. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 10. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Korrik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, KKS-së dhe Komitetit për Komunitete. 4. Publikimi i raportit gjashtëmujor financiar për vitin 2026. 5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 6. Publikimi i raportit 6 mujor për kërkesat për qasje në dokumente publike. 7. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 8. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera. 9. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 10. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Gusht	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, dhe Komitetit për Komunitete. 4. Përgatitja e njoftimit për organizimin e dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e buxhetit 2027 5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 6. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 7. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera.

	8. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 9. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Shtator	1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, KKS-së dhe Komitetit për Komunitete. 4. Publikimi i raporteve të procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore. 5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 6. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 7. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera. 8. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 9. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Tetor	1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Publikimi i raportit 9 mujor financiar. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 4. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, dhe Komitetit për Komunitete. 5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 6. Publikimi i raportit 9 mujor i kërkesave për qasje në dokumente publike. 7. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 8. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera. 9. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 10. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
Nëntor	1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së dhe Komitetit për Komunitete 4. Publikimi i agjendës së aktiviteteve për festat e 28 Nëntorit. 5. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 6. Publikimi i broshurave të ndryshme me qëllim të informimit të qytetarëve. 7. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera. 8. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal. 9. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.

Dhjetor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit Komunal. 2. Publikimi i planit të punës të Ekzekutivit për vitin 2027. 3. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e konsultimeve publike. 4. Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, KPF-së, KKS-së dhe Komitetit për Komunitete. 5. Publikimi i planeve të punës së drejtorive dhe sektorëve. 6. Publikimi i aktiviteteve të prokurimit. 7. Publikimi i njoftimeve, konkurseve, thirrjeve, ankandeve dhe dokumenteve të tjera. 8. Publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit komunal. 9. Publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave të tjera që paraqiten me kohë.
---------	--

Plani vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Plani Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën 2026 – 2028, i miratuar nga Kryetari i Komunës së Skenderajt. Plani përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Plani Vjetor duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në Komunën e Skenderajt (KS) apo në mesin e anëtarëve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), dhe çdo detyrë shtesë që propozohet nga Kryetari.

Auditimet e Brendshme të planifikuara të kryhen nga NjAB për vitin 2026;

1. Kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e DKRS-së;
2. Performanca në menaxhimin e Kontratave (Auditim i performancës);
3. Të hyrat nga Drejtoria e Urbanizimit;
4. Procesi i pagesave dhe realizimi i tyre nga Drejtoria e Financave;
5. Auditim me kërkesë (ad hoc) - sipas kërkesës së menaxhmentit;

Detyrë shtesë është monitorimi i implementimit të rekomandimeve nga viti paraprak 2025 dhe raportimi i tyre tek Kryetari i Komunës.

Detyrat e auditimit të planifikuara në Planin Strategjik dhe Planin Vjetor për NjAB-në janë si vijon:

Nr.	Njësia e synuar e auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	E planifikuar për vitin 2024	Nr. i detyrës së auditimit
1.	Kategoria e subvencioneve nga DKRS;	2.15	M	2026	2401
2.	Performanca në menaxhimin e Kontratave (Auditim i performancës);	2.55	L	2026	2402
3.	Të hyrat nga Drejtoria e Urbanizimit;	2.70	L	2026	2403
4.	Procesi i pagesave dhe realizimi i tyre nga Drejtoria e Financave;	1.60	M	2026	2404
5.	Auditim sipas kërkesës;			2026	2405
6.	Implementimi i rekomandimeve për vitin përkatës;	1.60	U	2026	2407

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2026 përputhen me Planin Strategjik të aprovuar të auditimit. Raporti në mes të detyrave të planifikuara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor tregohet në tabelë dhe është si vijon:

Llojet e detyrave të auditimit;	Numri i detyrave për vit;	Numri i përgjithshëm i ditëve për person/auditor;	Detyrat e auditimit sipas Planit Strategjik;	Zbatimi i Planit i shprehur në Përqindje;
Detyrat për shërbimet e sigurisë	5			
Rrezik i lartë	2			
Rrezik i mesëm	2			
Rrezik i ulët				

Përcjellja e rekomandimeve	1		
Punët tjera të auditimit			

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Qëllimi i NJMBNJ për vitin 2026 është përcaktimi i prioriteteve dhe objektivave kryesore, në përputhje me kompetencat ligjore dhe nevojat institucionale, duke siguruar shërbime profesionale, transparente dhe efikase në fushën e shërbimit civil.

Misioni i njësisë është administrimi i saktë dhe modern i burimeve njerëzore, mirëmbajtja e regjistrave të nëpunësve civil dhe ofrimi i shërbimeve cilësore, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, sipas legjislationit në fuqi.

Vizionin e realizon përmes zhvillimit profesional të staffit, digjitalizimit të proceseve, integrimin të sistemeve elektronike dhe respektimit të afateve ligjore. Njësia mbulon funksionet e regjistrimit dhe mirëmbajtjes së të dhënave për nëpunësit civil, arkivimin dhe digjitalizimin e akteve, si dhe ofrimin e shërbimeve efikase dhe transparente për qytetarët dhe institucionet komunale.

Zyra Ligjore

Në kuadër të kompetencave të veta dhe sipas kërkesave gjatë vitit 2026, Zyra Ligjore do të vazhdojë të hartojë, përpilojë vendime, autorizime, urdhëresa, përgjigje në kërkesa dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe mekanizmat e tjerë të formuar nga autoriteti i Komunës së Skenderajt.

Gjithashtu, sipas kërkesave dhe udhëzimeve të nivelit të lartë, Zyra Ligjore jep opinione ligjore dhe harton projekt-marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Gjatë vitit 2026, Zyra për Komunitete dhe Kthim do të vazhdojë të mbështesë integrimin dhe përfaqësimin e komuniteteve në Komunën e Skenderajt, duke zbatuar politika të barazisë. Zyra do

të organizojë aktivitetet për përkrahjen e kthimit dhe riintegrimin të personave të kthyer në komunë, duke koordinuar me institucionet qendrore dhe organizatat ndërkombëtare dhe lokale.

Për vitin 2026, në fokus të Zyrës do të jenë: monitorimi i nevojave të komuniteteve, zhvillimi i programeve sociale dhe arsimore për përfshirjen e komuniteteve, sigurimi i asistencës në çështje të pronës dhe legalizimeve për personat e kthyer, si dhe promovimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërkomunitar.

Zyra do të ofrojë gjithashtu informacion dhe mbështetje për qytetarët lidhur me të drejtat, shërbimet dhe mundësitë e përfshirjes në jetën komunitare dhe institucionale.

Drejtoria për Administratë

Drejtoria e Administratës ka për qëllim ofrimin e shërbimeve administrative sa më afër qytetarëve, respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe realizimin e shërbimeve publike në forma të përshtatshme për qytetarët.

Drejtoria për Administratë që të arrijë objektivat e saj, do të ketë aktivitetet në bazë të planit të punës, ku do të funksionoj në sektorë, njësi dhe zyra si vijon:

Tabela e aktiviteve sipas sektorëve:

Nr.	Sektori / Qëllimi	Aktiviteti kryesor	Stafi përgjegjës	Afati
1.	Sektori i Gjendjes Civile	Pranimi dhe procesimi i kërkesave për dokumente personale përmes sistemeve elektronike (Intranet, GJC, sistemi i radhës), si dhe zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve të ARC-së dhe MPB-së	Udhëheqësi i Sektorit të GJC-së, Zyrtarët e Gjendjes Civile në Skenderaj dhe zyrat në terren	Janar– Dhjetor
2.	Sektori i Administrimit me Dokumente / QSHQK – Arkivi	Pranimi, evidentimi dhe përcjellja e kërkesave dhe akteve; pranimi dhe regjistrimi i postës; arkivimi i lëndëve dhe zbatimi i legjislationit në fuqi	Udhëheqësi i QSHQK-së/Arkivit, zyrtarët e protokollimit dhe arkivit	Janar– Dhjetor
3.	Zyra e Përkthimeve	Përkthimi i akteve të Ekzekutivit dhe Kuvendit Komunal, si dhe përkthimi	Zyrtari i Përkthimeve	Janar– Dhjetor

		simultan në takime me komunitetet			
4.	Menaxhimi Administrativ (DA)	Organizimi i takimeve të rregullta për koordinim, disiplinë dhe mbarëvajtje të punës	Organizimi i takimeve të rregullta për koordinim, disiplinë dhe mbarëvajtje të punës	Drejtori, udhëheqësit e sektorëve dhe zyrtarët përkatës	Sipas agjendës
5.	Njësia e Transportit	Menaxhimi i kërkesave për transport zyrtar, mirëmbajtja e automjeteve, evidencia e lëvizjeve, përdorimi i GPS-it dhe mirëmbajtja e objekteve komunale	Menaxhimi i kërkesave për transport zyrtar, mirëmbajtja e automjeteve, evidencia e lëvizjeve, përdorimi i GPS-it dhe mirëmbajtja e objekteve komunale	Udhëheqësi i Njesisë së Transportit, vozitësit dhe mirëmbajtësi	Janar– Dhjetor
6.	Sektori për Integritet Evropiane, DNJ dhe Barazi Gjinore	Avancimi i të drejtave të njeriut, raportimi i obligimeve nga Agjenda Evropiane, këshillimi dhe monitorimi i aktiviteteve institucionale	Avancimi i të drejtave të njeriut, raportimi i obligimeve nga Agjenda Evropiane, këshillimi dhe monitorimi i aktiviteteve institucionale	Udhëheqësi i sektorit dhe zyrtarët përkatës	Janar– Dhjetor
7.	Logjistika / Zyra e TI-së	Mirëmbajtja e serverëve, rrjetit dhe aplikacioneve komunale; avancimi i e-qeverisjes; sigurimi i licencave dhe bashkëpunimi me MAP/ASHI	Mirëmbajtja e serverëve, rrjetit dhe aplikacioneve komunale; avancimi i e-qeverisjes; sigurimi i licencave dhe bashkëpunimi me MAP/ASHI	Zyrtarët e Teknologjisë Informative dhe Logjistikës	Janar– Dhjetor

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa vazhdon të funksionojë edhe gjatë vitit 2026 në dy sektore:

1. Sektori i Buxhetit dhe Financave
2. Sektori i Tatimit në Pronë

Sektori i Buxhetit dhe Financave

- Plani i rrjedhës së parasë për të gjitha programet buxhetore;
- Bartja e mjeteve të mbetura (të hyrat komunale) nga viti 2025;
- Raportet periodike tremujore për investime kapitale;

- Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB;
- Rishikimi buxhetor gjashtëmujor për vitin 2026 (sipas instruksioneve nga MF-ja, nëse mundësohet);
- Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal 2026;
- Përgatitja e KAB-it komunal 2027–2029 dhe planifikimi i buxhetit për vitin 2027, konform qarkoreve buxhetore të MF-së dhe udhëzimeve përkatëse;
- Përgatitjet dhe aktivitetet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2026;
- Raportet periodike dhe përfundimtare të buxhetit për Kuvendin Komunal dhe dorëzimi i tyre në MF;
- Planifikimi i të hyrave sipas llojeve dhe programeve brenda komunës, si dhe harmonizimi i tyre sipas pozicioneve buxhetore, brenda kufijve të buxhetit të planifikuar dhe miratuar;
- Raportet mujore për arkëtimin e të gjitha të hyrave komunale sipas llojeve dhe programeve;
- Arkëtimet ditore të të hyrave nga taksat dhe tarifat për shërbimet e ofruara nga komuna;
- Regjistrimi ditor i të hyrave në sistemin FreeBalance të MF-së dhe nxjerrja e raporteve bankare që pasqyrojnë të hyrat e arkëtuara;
- Barazimet mujore me drejtoritë komunale dhe me Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave;
- Shpërndarja dhe alokimi mujor i të hyrave të realizuara sipas pozicioneve buxhetore;
- Kryerja e detyrave të tjera të përcaktuara nga Drejtori i Drejtorisë.

Në mënyrë tabelore bartësit e detyrave dhe afatet kohore:

Nr.	Aktivitetet:	Bartësi i aktiviteve:	Planifikimi i realizimit:	Komente:
1	Mbyllja e vitit 2025 dhe fillimi i vitit 2026 me buxhetin programor sipas drejtorive	DBF – Evidentimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas drejtorive	Muaji janar dhe në vazhdimësi gjatë tërë vitit	Dhe në vazhdimësi gjatë tërë vitit.

2	Raporti vjetor mbi borxhet e mbetura të komunës për vitin 2025	DBF – Sektori i Administratës Komunale, Arsimit, Shëndetësisë dhe Zyra e Prokurimit	Muaji janar	Deri më 15.01.2026
3	Rrjedha e parasë për të gjitha drejtoritë dhe zyrat komunale	DBF – Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji janar	Për të gjitha programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike
4	Raporti financiar për vitin 2025	DBF – Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji janar	Aprovimi në KPF dhe Kuvend
5	Shtypja dhe shpërndarja e faturave tatimore për tatimin në pronë	DBF – Sektori për Tatim në Pronë	Janar – Mars	Dhe në vazhdimësi deri në fund të muajit Mars
6	Përgatitja e raportit financiar tremujor (janar–mars 2026)	DBF – Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji prill	Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike
7	Mbajtja e evidencës kontabël të të hyrave komunale	DBF – Zyrtari i të hyrave komunale	Gjatë vitit fiskal, me prejere mujore	Barazime mujore me MF / Thesarin
8	Rishikimi buxhetor për vitin 2026	DBF – për secilin program buxhetor	Muaji maj (dhjetëditëshi i parë)	Rishikim i pozicioneve shpenzuese
9	Raporti financiar gjashëmujor (janar–qershor)	DBF – Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji korrik	Bazuar në barazimet me FreeBalance
10	Përcjellja e realizimit të buxhetit 2026	DBF – Sektori i Buxhetit dhe Financave	Gjatë gjithë vitit fiskal 2026	Bazuar në rregulloret financiare
11	Përgatitja e buxhetimit programor 2027–2029	DBF – në koordinim me të gjitha drejtoritë	Muaji shtator	Bazuar në Qarkoret Buxhetore
12	Bilanci i gjendjes dhe regjistrimi i mjeteve dhe pasurisë	Zyrtari për evidencën e mjeteve dhe pasurisë	Gjatë vitit fiskal 2025	Rregullorja nr. 02/2013
13	Barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me FreeBalance	DBF – në koordinim me Arsimin dhe Shëndetësinë	Deri më 15.01.2027	Rregulloret Financiare të Thesarit

Sektori i Tatimit mbi Pronën

Objektivat e sektorit për Tatim ne Pronë:

Për vitin 2026 parashihen fatura tatimore aktive rreth 8500 me një ngarkesë e cila do te saktësohet në gjysmën e parë të Janarit 2026 atëherë edhe kur do të dalin faturat e para në sistem, ku nga këto fatura sipas planit buxhetor 2026 synohet një realizim prej 432.600.00 € edhe kjo sipas llojeve të pronave:

- a) për objekte 350,000.00 €
- b) për parcela toke..... 82.600.00 €.

Normat tatimore të vitit 2025 do të jenë në fuqi edhe për vitin 2026 meqenëse ekzekutivi nuk ka propozuar ndryshime për të gjitha llojet e pronave të paluajtshme duke përfshirë edhe parcelat bujqësore për të cilat aplikohet tatimi që nga viti 2024 për herë të parë. Shpërndarja e faturave deri tek obliguesit tatimor do të bëhet në periudhën Janar-Mars. Gjatë viteve paraprake shpërndarja e faturave është bërë me kontratë përmes postës, ndërsa edhe për vitin 2026 pretendohet të vazhdoj në të njëjtën mënyrë.

Gjatë vitit 2026, parashihet që të regjistrohen afërsisht 550 objekte të reja dhe 20% verifikime të pronave ekzistuese me një plan të implementimit me detaje për zyrtarët për funksionet mbështetëse (klasifikim i pronave, inspektimi i pronave) në terren, të ndarë në lagje të qytetit dhe fshatra. Plani më detaje i veprimit me periudha kohore tu dërgohet ekipeve përkatëse të terrenit.

Ndërgjegjësimi dhe Informimi i Tatimpaguesve

- Fushata informuese: Organizimi i fushatave për të informuar qytetarët dhe bizneset për detyrimet tatimore, afatet dhe sanksionet për mos-pagimin e tatimit në pronë. Ky informacion mund të shpërndahet përmes mediave, webfaqë-ve të institucioneve tatimore, letrave dhe njoftimeve të drejtpërdrejta.

Përmirësimi i Shërbimeve të Tatimpaguesve

- Shërbim nëpërmjet zyrave të tatimit: Përdorimi i një rrjeti të gjerë zyrash të tatimit për mbledhjen e tatimit në pronë dhe për asistencën e tatimpaguesve.
- Masa për reduktimin e proceduarve: Sigurimi që procedurat për regjistrimin dhe pagesën të jenë të thjeshta dhe të shpejta, për të inkurajuar njerëzit të paguajnë në kohë

- **Kontrolle dhe inspektime të rregullta:** Përdorimi i ekipeve inspektuese për të kontrolluar pronat dhe për të verifikuar nëse janë regjistruar dhe paguar tatimet përkatëse. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e tatimpaguesve që shmangin pagesën e tatimit.
- **Ndjekja e pagesave:** Krijimi i një sistemi të koordinuar për ndjekjen e pagesave dhe shtrirjen e mundësive për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura përmes planifikimit të pagesave me këste.
- **Sanksione për pagesat e vonuara:** Aplikimi i sanksioneve për ata që nuk paguajnë në afatin e caktuar,
- **Duke përfshirë kamatë vonesë dhe mundësinë e sekuestrimit të pasurive për mbledhjen e detyrimit.**
- **Rritja e angazhimit të autoriteteve lokale:** Bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe përdorimi i sistemeve të regjistrimit të pasurive të patundshme për të përmirësuar saktësinë e informacionit dhe për të mbledhur tatimet e pronës.
- **Pjesëmarrja e komunitetit:** Organizimi i aktiviteteve në nivel lokal për të inkurajuar tatimpaguesit të respektojnë ligjin dhe të mbështesin shërbimet publike që financohen përmes këtyre tatimeve.
- **Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë:** Publikimi i informacioneve në lidhje me përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga tatimi në pronë dhe rritja e transparencës për mënyrën se si shpenzohen ato.

Planifikimi dhe aktiviteti sipas muajve për vitin 2026:

Muaji	Aktiviteti	Planifikimi
1 Janar	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin.	365
2 Shkurt	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	350
	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave	

3	Mars	të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	370
4	Prill	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	365
5	Maj	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	400
6	Qershor	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	350
7	Korrik	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	300
8	Gusht	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	320
9	Shtator	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	370
10	Tetor	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	380
11	Nëntor	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	350

12	Dhjetor	Inspektime në terren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	300
		Gjithsej: aktivitetet në terren	4220

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm

Plani i punës i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm për vitin 2026 është në harmoni të plotë me planet e punës së Qeverisë Komunale të Skenderajt, duke respektuar në tërësi legjislacionin dhe rregulloret në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040;
- Urdhëresat administrative përkatëse;
- Rregulloret komunale në fuqi;
- Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Nr. 04-020/01-0006968/22.

Qëllimi dhe Prioritetet Kryesore:

Prioritet kryesor i Drejtorisë është krijimi i politikave publike të favorshme dhe ofrimi i infrastrukturës së nevojshme për:

- Nxitjen e investimeve vendore dhe të huaja;
- Përkrahjen e bizneseve ekzistuese dhe atyre të reja;
- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik lokal.

Duke u bazuar në potencialet ekzistuese dhe perspektivën për rritje ekonomike, gjatë vitit 2026 vëmendje e veçantë do t'i kushtohet:

- Zhvillimit dhe promovimit të turizmit lokal;

- Shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe atraksioneve turistike për investime;
- Krijimit të mekanizmave për përfshirjen aktive të diasporës në zhvillimin ekonomik të komunës.

Gjithashtu, do të intensifikohet bashkëpunimi me: Partnerë të Partneritetit Publiko-Privat (PPP), Investitorë vendorë dhe ndërkombëtarë, donatorë dhe organizata zhvillimore, me qëllim të realizimit të projekteve zhvillimore, tërheqjes së investimeve, si dhe implementimit të ideve dhe projekteve inovative në Komunën e Skenderajt.

Promovimi i Produkteve dhe Shërbimeve

Në bashkëpunim me institucionet relevante, Drejtoria do të angazhohet për:

- Nxitjen dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve vendore;
- Mbështetjen e prodhuesve lokal dhe ndërmarrësve inovativë;
- Zhvillimin e sektorëve prioritarë të ekonomisë lokale dhe turizmit.

Aktivitete të Zhvillimit Ekonomik:

Nr	Aktiviteti	Përshkrimi	Rezultatet e Pritshme
1.1	Promovimi i komunës	Organizimi i forumeve, takimeve me investitorë & diasporën	Rritje e investimeve
1.2	Platforma "Invest in Skenderajt"	Platformë digjitale me zona të lira për investim	Transparencë & promovim
1.3	Brendi i Komunës	Logo, brand-book, materiale promovuese	Identitet i unifikuar
1.4	Panaire lokale	Artizanat, gratë ndërmarrëse, prodhime vendore	Rritje e shijëve dhe promovimit
1.5	Grante për start-up	Mbështetje teknike dhe financiare	30 biznese të reja
1.6	Praktika profesionale	Angazhim i të rinjve në institucione dhe biznese	Punësim i të rinjve
1.7	Mbështetje për OShC	Projekte për zhvillim ekonomik, turizëm dhe inovacion	Fuqizim i komunitetit
1.8	E-shërbimet për bizneset	Regjistrimi online, vërtetime, ndryshime	Procedura e shpejt
1.9	Raporte ekonomike mujore	Publikimi i statistikave të tregut lokal	Vendimmarrje më e mirë

Inovacioni dhe Teknologjia:

Nr	Aktiviteti	Përshkrimi	Rezultatet
2.1	Smart Skenderaj	Sensorë ajri, panele informuese, aplikacione	Digjitalizim i shërbimeve
2.2	Trajnime teknologjike	Robotikë, programim, digjitalizim	200 të rinj të trajnuar
2.3	Projekte me donatorë	Aplikime të USAID, GIZ, EU	Rritja e fondeve

Zhvillimi i Turizmit:

Nr	Aktiviteti	Përshkrimi	Rezultatet
3.1	Shtigjet e çiklizmit	Zgjerimi i shtigjeve ekzistuese	Shtigje të reja
3.2	Investim në parqe	Hapësira rekreative, ndriçim, pushimore	Zonë moderne rekreative
3.4	Shtigje ecjeje	Hiking trails me sinjalistikë	Atraksione të reja
3.6	Harta digjitale e turizmit	QR kode, aplikacion “Visit Skenderaj”	Promovim modern
3.7	Evente turistike	Festivali Drenicak, Gara e Çiklizmit, Panairi Lokal	Rritje e vizitorëve 30%
3.8	Turizmi virtual	Prezantim digjital i pikave turistike	Promovim Kombëtar

Drejtoria e Prokurimit Publik

Plani i punës i Drejtorisë së Prokurimit duhet të jetë i harmonizuar dhe të korrespondojë me kufijtë e buxhetit të Autoritetit Kontraktues për vitin 2026, për të gjitha shtyllat e buxhetit. Drejtoria e Prokurimit, në kuadër të autorizimeve ligjore dhe përgjegjësi të saj, me autorizimin e ZKA-së, do të procedojë në zhvillimin e procedurave për lidhjen e kontratave publike për kategoritë mallra dhe shërbime që skadojnë gjatë vitit fiskal, si dhe për projektet e reja kapitale të paraparë në kuadër të buxhetit për vitin 2026 (përfshijtur ndryshimet e projekteve me rishikim të buxhetit dhe përcjelljen e procedurave që rrjedhin nga viti paraparak).

Drejtoria e Prokurimit gjatë vitit 2026 planifikon të kryejë këto veprimtari në kuadër të Njësive Kërkuese të Komunës së Skenderajt dhe Drejtorisë:

1. Përgatitja e buxhetit për vitin 2026 (korniza afatmesme buxhetore, rjedha e parasë, përcjellja e buxhetit dhe shfrytëzimi i tij në mënyrë transparente), përgatitja e planit preliminar dhe përfundimtar të prokurimit.
2. Përgatitja e raporteve të punës (muajore dhe vjetore).
3. Në bashkëpunim me Njësitë Kërkuese dhe ZKA (Kryetarin e Komunës) do të hartohet Plani përfundimtar i prokurimeve për vitin 2026 sipas LPP-së dhe Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dhe do të dorëzohet në AQP.
4. Finalizimi i Raportit përfundimtar për kontratat e nënshkuara dhe dorëzimi i tij në KRPP (Janar 2026).
5. Në muajin Janar 2026 do të kryhen të gjitha procedurat për interes të Njësive Kërkuese, përfshirë furnizime, shërbime, punë (kapitale), konkurse projektimi dhe procedura të tjera emergjente ose të ngjashme të përfshira në Planifikimin përfundimtar të Prokurimit (AQP).
6. Nga muaji Janar 2026 do të fillohet zhvillimi i procedurave, caktohen anëtarët e komisioneve për vlerësim, propozohet menaxheri/mbikëqyrësi, ndërsa ZKA do të nxjerrë vendim dhe do ta nënshkruajë sipas legjislacionit në fuqi.
7. Hartimi i listës së anëtarëve të komisioneve për hapje të tenderëve, të cilët do të marrin pjesë në hapjen e ofertave.
8. Publikimi i të gjitha procedurave të inicuar nga Njësitë Kërkuese për furnizime, shërbime dhe punë (projekte kapitale si projektme) sipas Planit Preliminar të Prokurimeve 2026.
9. Publikimi i tenderëve do të bëhet sipas Planit të Prokurimeve dhe kërkesave që vijnë nga Njësitë Kërkuese.
10. Gjatë vitit 2026 Drejtoria e Prokurimit do të kryejë procedura pa publikim të njoftimit për kontratë ose me negociatë (aneks kontrata), kuotime çmimesh dhe vlera minimale sipas nevojës së Njësive Kërkuese.
11. Hartimi i raporteve javore, muajore dhe tremujore, të cilat do të dorëzohen tek Zyra e Kryetarit dhe në KRPP.
12. Insistimi që të gjitha kushtet dhe kriteret të hartohen konform LPP-së dhe në bashkëpunim me Njësitë Kërkuese.

13. Kërkesat fillestare do të pranohen vetëm për procedura të përfshira në Planifikimin përfundimtar të Prokurimit dhe për punë të tjera të detyruara nga LPP, Rregullorja, Udhëzuesi dhe legjislacioni në fuqi.

14. Harmonizimi me buxhetin – të gjitha aktivitetet e planifikuara janë në përputhje me linjat buxhetore të miratuara për vitin 2026 dhe nuk tejkalojnë kufijtë financiarë të përcaktuar.

15. Plani do të monitorohet gjatë gjithë vitit 2026. Çdo ndryshim do të bëhet vetëm me arsyetim dhe miratim zyrtar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtoria e Prokurimit Publik për vitin 2026 do të jetë e përkushtuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, zhvillimin e kapaciteteve të personelit, përdorimin efikas të buxhetit, menaxhimin e ankesave dhe qasjen transparente për të gjitha palët e interesit dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) ushtron kompetencat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke zbatuar politikat komunale në fushën e bujqësisë, pylltarisë, resurseve natyrore dhe zhvillimit rural. Drejtoria bashkëpunon ngushtë me MBPZHR dhe institucionet përkatëse për mbështetjen e fermerëve, zhvillimin e prodhimit bujqësor, mbrojtjen e tokës bujqësore, faunës së egër dhe shëndetit të bimëve dhe kafshëve. Gjithashtu, DBPZHR ofron këshillime profesionale, organizon trajnime, siguron dhe promovon subvencione dhe grante, ndërmerr masa për parandalimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe mbikëqyr menaxhimin e vendgjuesitë, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm rural të Komunës së Skenderajt.

Aktivitetet që do të zbatohen gjatë vitit 2026:

1. Monitorimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore;
2. Mbikëqyrja e menaxhimit të vendgjuesitë “Drenica”;
3. Monitorimi i granteve të realizuara nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe donatorët;
4. Organizimi i trajnimeve për fermerë;

5. Implementimi i projektit për këshillime me fermerë, si dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme;
6. Ofrimi i këshillave për fermerët për krasitje në plantacionet ekzistuese, dhënia e këshillave për mbrojtjen e pemëve nga dëmtuesit dhe sugjerimi rreth mënyrës së mirëmbajtjes së pemishteve nga ana e fermerëve;
7. Ofrimi i informacioneve rreth granteve për mbështetjen e fermerëve nga MBPZHR;
8. Ndarja e granteve për fermerët e Skenderajt nga DBPZHR për vitin 2026;
9. Pranimi i aplikacioneve për bujqit për subvencione nga MBPZHR;
10. Përcjellja në terren dhe këshillimi për zhvillimin e kulturave të mbjella në vjeshtë dhe pranverë;
11. Përgatitja e planit për fushatën e korrije-shirjeve në Komunën e Skenderajt;
12. Monitorimi i punës së autokombajnave në terren;
13. Organizimi i takimeve me fermerët e perimekulturës, blegtorisë, pemëtarisë dhe bletarisë;
14. Plani i mbjelljeve vjeshtore në Komunën e Skenderajt;
15. Organizimi i trajnimeve me bujqit për mundësinë e rritjes së rendimentit të kulturat lavërtare, si dhe masat agroteknike.

Me këtë plan të punës, DBPZHR synon të ofrojë ndihmë dhe ekspertizë për fermerët dhe qytetarët në këto fusha:

1. Subvencione në mjete të punës dhe mekanizëm bujqësor për fermerë;
2. Trajnime dhe këshilla për fermerë;
3. Subvencionimi i perimtarisë, bletarisë, blegtorisë dhe sektorëve të tjerë të bujqësisë;
4. Këshillimi dhe inkurajimi i fermerëve për aplikim për grante që ofrohen nga MBPZHR;
5. Trajtimi human i qeneve endacakë;
6. Mbikëqyrja e menaxhimit të vendgjuetisë “Drenica” në Skenderaj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

Planifikohet që punët administrative të përfundojnë brenda afateve të parapara ligjore, pa vonesa dhe ngecje. Duke marrë parasysh natyrën e lëndëve të Drejtorisë për Urbanizëm, veçanërisht ato

që lidhen me lejet ndërtimore, pranimet teknike, kërkesat e qytetarëve për projekte infrastrukturore, si dhe lëshimin e vërtetimeve dhe certifikatave, synohet trajtimi i tyre me kohë dhe efikasitet.

Drejtoria për Urbanizëm, në bazë të Statutit të Komunës dhe kompetencave që i takojnë, ka përpiluar listën e projekteve për vitin 2026, si dhe projektet e bartura nga vitet paraprake – kontrata kornizë.

Projekte të vazhdueshme (nga vitet paraprake). Projektet dy-tri vjeçare:

- Hartimi i projekteve teknike (vazhdim)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjeve në Burojë (vazhdim)
- Trotuarët dhe ndriçimi në BL Likovc, Klinë e Epërme, Polac, Runik, Turiqevc (vazhdim)
- Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha (vazhdim)
- Kanalizimi Syriganë, Banjë–Pemishtë (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 – Prekaz (përfunduar)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez (vazhdim)
- Ndërtimi i rrugës Kozhicë–Qyqavicë (përfunduar)
- Ndërtimi i rrugës Syriganë–Bjeshka e Syriganës (përfunduar)
- Rregullimi i subqendrave: Likovc, Runik, Qirez (vazhdim)
- Tribunat në stadiumin e qytetit (vazhdim)
- Kanalizimi Klinë–Kuqicë (vazhdim)
- Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i ulët, si dhe BL Runik, Prekaz, Turiqevc, Qirez, Rezallë, Klinë e Epërme, Polac dhe qytet (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë, Qubrel, Kosterc, Vitak, Klladernicë, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Klinë, Prekaz, Mikushnicë, Polac, Makermal, Rakinicë, Llaushë (vazhdim)
- Ndërtimi i urave në fshatrat Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Terrnavc, Tushilë, Kllodenicë (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës lagja Zabeli deri te shkolla Malush Ahmeti dhe rrugët lidhëse faza 2 – Rezallë e re (vazhdim)
- Poligoni sportiv i shkollës Ahmet Delia (vazhdim)

- Ndërtimi i çerdes për fëmijë – vazhdimi i aneksit të dytë (vazhdim)
- Kanalizimi fekal Izbicë–Rakinicë dhe Leqinë (vazhdim)
- Riparimi, asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet dhe BL Likovc, Turiqevc, Runik, Qirez (vazhdim)
- Ndërtimi i muzeut dhe bibliotekës së qytetit (vazhdim)
- Rregullimi i shtatit të lumit Klinë e ulët–Kuqicë dhe dy degëzimet e Llaushës (vazhdim)
- Ndërtimi i shëtitores natyrale dhe hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina (vazhdim)
- Riparimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha" (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës Klinë e Epërme (vazhdim)
- Kycja e kanalizimit lagja Kodra–Polac (vazhdim)

Projekte të parashikuara për vitin 2026

- Korrigjimi i hartës zonale (HZK)
- Ndërtimi i kolektorit Llaushë–Tushilë–Aqarevë, faza I (vazhdim)
- Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha – aneks kontrata
- Riparimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha" – aneks kontrata
- Rregullimi i kulmit të objekteve – banesat e kuqe
- Ndërtimi i objektit të Kompleksit të UÇK-së – Objekti Ç-së
- Asfaltimi i rrugëve lokale në BL: Likovc, Turiqevc, Runik, Polac, Klinë, Prekaz, Qirez
- Rreth-rrrotullimi në hyrje të kompleksit – Prekaz dhe nënkalimi në sheshin Adem Jashari

Projekte në bashkëfinansim me investitorë dhe donatorë të jashtëm Të vazhdohet me bashkëfinansimet ekzistuese sipas marrëveshjeve të parapara në projektet e vitit paraprak dhe ato të reja të identifikuar për vitin 2026.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ka katër sektorë dhe secili prej tyre ka të hartuar planin e detajuar të aktiviteteve vjetore, plane të cilat janë përmbledhura.

Për shkak të natyrës së punës së DKRS-së, çdo vit ajo realizon edhe aktivitete të paparapara në Planin e punës të cilat dalin si nevojë e institucioneve lokale të Komunës së Skenderajt.

Tabela e aktiviteteve:

Nr.	Aktivitetet	Sektori	Afati
1	“17 Shkurti” - Dita e Pavarësisë së Kosovës. Aktivitetet përkujtimore, kulturore, sportive dhe rinore.	K.R.S	Shkurt
2	“28 Shkurti” – Beteja e Çirezit Likoshanit. Akademi, aktivitete të tjera, sigurimi i hapësirave sportive dhe pranimiti i projekteve/kërkesave nga klubet për subvencione.	Kulturë, Sport	Shkurt
3	Java kulturo-sportive “Jetojmë me lavdinë tuaj” – “Epopeja e UÇK-së”. Turne në futboll, shigjetari dhe volejboll.	K.R.S	1-7 Mars
4	Avancimet kulturore “Prof. Ajet Beqiri”. Gara nxënësish në letërsi dhe pikturë. Turneu memorial “Ilir Lushtaku” në futboll të vogël.	K.R.S	25-26 Mars
5	28 Mars - Dita e përkujtimit të të rënëve, dëshmorëve dhe martirëve. Tubim përkujtimor në Izbicë.	K.R.S	26-28 Mars
6	Aktivitetet përkujtimore kushtuar Ilaz Kodrës. Turneu memorial në futboll të vogël “Ilaz Kodra”. Promovimi i trashëgimisë kulturore.	Sport	Prill
7	Aktivitet me maturantët. Java e dhurimit të librit, orë letrare me poetët e Skenderajt, pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj.	Rini, Biblioteka	Maj
8	Dita e Fëmijëve, takimet e teatrove shkollore. 18 Qershor – Dita e Çlirimit të Skenderajt. Kolonia e artistëve. Ditët e muzeut dhe arkivit.	K.R.S	Qershor
9	Aktivitete kushtuar “Ditës së Mërgatës”. Koncert nga Ansambli “Drenica”. Vizita muzeu dhe monumente historike.	K.R.S	Gusht
10	Muaji rinor. Pjesëmarrje në aktivitete teatrale jashtë Skenderajt.	K.R.S	Shtator

11	Aktivitetet tjera rinore dhe shoqërore. Shënimi i festave ndërkombëtare.	Rini	Gjatë gjithë vitit
12	Mbështetja e Qendrës Rinore Publike.	Rini, Kulturë	Gjatë gjithë vitit
13	Aktivitetet rinore -- Muaji i Rinisë	Rini	Shtator
14	28 Nëntor – Aktivitete përkujtimore. Festival Folklorik “Rapsodia Shqiptare”.	K.R.	26-28 Nëntor
15	Mbështetje financiare për Ansamblin “Drenica” dhe mbarëvajtja e aktiviteteve kulturore.	Kulturë	Mars – Qershor
16	Aktivitetet kulturore (Muzeu, Arkivi, Teatri). Pjesëmarrje në aktivitete jashtë Skenderajt.	Kulturë	Gjatë gjithë vitit
17	Ndarja e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për rezultatet në kulturë, rini dhe sport.	K.R.S	Dhjetor
18	Aktivitetet tjera kulturore: promovime librash, ekspozita etj.	Kulturë, Biblioteka	Gjatë gjithë vitit
19	Mbrëmje e fund vitit me të rinj.	Rini	Dhjetor
20	Zgjedhja e Sportistit të Vitit, 30 Dhjetor – Sulmi i parë mbi familjen, prijta e Vitit të Ri.	Rini, Sport, Kulturë	Dhjetor
21	Organizimi i debateve dhe tryezave me të rinjtë.	Rini	Gjatë gjithë vitit
22	Mbështetja e klubeve sportive. Përcjellja e aktiviteteve të klubeve të regjistruara.	Sport	Gjatë gjithë vitit
23	Monitorimi i gjendjes së objekteve të trashëgimisë kulturore. Sigurimi i të dhënave për ndërhyrje.	Kulturë	Gjatë gjithë vitit

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale bëjnë pjesë:

1. Qendra e Kujdesit Parësor Shëndetësor (QKMF),
2. Qendra Për Punë Sociale (QPS) si dhe

3. Shtëpia për Persona të Moshuar dhe Pa Përkujdesje Familjare (SHPMPPF).

Po ashtu në kuadër të kujdesit dytësor shëndetësor funksionon Qendra e Shëndetit Mendor, ku trajtohen pacientet me çrregullime mendore. Ky institucion është nën kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë.

Objektivat kryesore të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqeniet Sociale për vitin 2026 janë:

- Rritje e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shërbimeve shëndetësore;
- Pajisja me aparaturë të nevojshme e QKMF-së;
- Furnizimi më i mirë me barëra dhe material shpenzues;
- Përkujdesja maksimale për të sëmuret;
- Mbikëqyrja e situatës në rast të epidemive në nivel lokal;
- Diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve;
- Përmirësimi i kujdesit për pacientët me çrregullime mendore;
- Sigurimi i masave mbrojtëse që kanë të bëjnë me: sigurimin dhe kontrollimin e ujit të pijshëm dhe higjienës, dezinfektimin dhe deratizimin, sigurimin e ushqimit të sigurt;
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale;
- Bashkëpunim me donator të huaj dhe vendor, me organizata qeveritare dhe joqeveritare me media elektronike dhe të shkruara.

Projektet e planifikuara :

- Fillimi i ndërtimit të ndërtesës së banimit të përballueshëm social në Kompleksin UÇK projekt i fituar dhe financuar nga Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Ndërtimi i 15 Shtëpive të reja të Rasteve sociale projekt i fituar dhe financuar nga Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Renovimi i 30 Shtëpive të Rasteve sociale po ashtu projekti i fituar dhe financuar nga Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)

Veprimtaria e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj përfshinë ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për të gjithë popullatën e Komunës, si një veprimtari me interes

të veçanta, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Komunës së Skenderajt.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Skenderaj, ka staf prej **195** punëtorësh, të cilët ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor për rreth **40.664** banorë të Komunës së Skenderajt. Por përmes grantit specifik për shëndetësinë primare sipas Qarkores Buxhetore 2026/01 shtohen edhe 4 pozita (në total 199), përmes së cilave është paraparë Intervënimi në fëmijërinë e hershme ku i shtohen stafit të QKMF-së në Skenderaj :

• Logoped-1 pozitë • Fizioterapeut-1 pozitë • Punëtor Social-1 pozitë • Psikolog Klinik-1 pozitë

Kujdesi Parësor Shëndetësor në Komunën e Skenderajt është i organizuar nëpërmes rrjetit shëndetësor si:

- QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Skenderaj,
- QMF – Pesë Qendra të Mjekësisë Familjare: - Runik, Qirez, Prekaz I Epërm, Likoc dhe Turiqec, si dhe nga
- AMF – tetë Ambulanca Familjare: - Qubrel, Klladernice, Klinë e Eperme, Rezallë, Aqarevë, Llaushë, Polac dhe Izbicë.

Plani i punës për vitin 2026 fokusohet në forcimin e Shëndetësisë Primare përmes rishikimit të sistemit ekzistues, rritjes së stafit shëndetësor në QKMF dhe QMF, ofrimin të shërbimeve në terren për nëna, fëmijë, persona të moshuar dhe persona me sëmundje kronike, si dhe intensifikimit të masave parandaluese. Prioritet i veçantë do t'i jepet imunizimit dhe vaksinimit, përfshirë vaksinimin kundër gripit sezonal, kontrolleve sistematike të nxënësve në shkolla dhe rritjes së përkujdesjes për personat me nevoja të veçanta.

Projektet e planifikuara

1. Renovimi dhe rehabilitimi i Qendrave të Mjekësisë Familjare;
2. Pajisje për lavanderi në QKMF;
3. Përfundimi dhe aktivizimi i QMF-së së re në Lagjen III të qytetit;

Qendra për Punë Sociale;

Qendra për Punë Sociale si institucion profesional publik si degë e administratës në kuadër të DSHMS në nivelin Komunal që ka për mandat mbrojtjen sociale të qytetarëve në nevojë, i kryen të gjitha detyrimet programore në planin e mbrojtjes së familjës (fëmijëve, të rinjëve, të rriturëve

në gjendje të nevojës sociale, të moshuarëve, të pa aftëve dhe personave tjerë me aftësi të kufizuara), dhe detyra tjera të kësaj fushë-veprimtarie.

QPS-ja është e organizuar në tre sektor:

1. Sektori për Shërbime Sociale, në këtë sektor janë të punësuar 6 zyrtar profesional
2. Sektori për Skemën e Ndhmës Sociale-në këtë sektor janë të punësuar 7 zyrtar
3. Sektori apo zyra për Administrate dhe Financa 1 zyrtar

Shtëpia për Persona të Moshuar dhe pa përkujdesje Familjare(SHPMPF)

Në SHPMPF janë të vendosur gjithsejtë 24 të moshuar. SHPMPF është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve 24h, ushqim, strehim, përkujdesje mjekësore.

Plani i SHPMPF për vitin 2026

- Renovimi i Shtëpisë për Persona të Moshuar dhe Pa Përkujdesje Familjare;
- Furnizim dhe rregullim i lavanderisë dhe kuzhinës industriale;
- Furnizimi i rregullt me medikamente mjekësore;
- Furnizim me veshmbathje për të moshuarit;

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Qëllimi i Drejtorisë është ngritja e nivelit të shërbimeve efektive dhe cilësore ndaj qytetareve si dhe përmirësimi i kushteve sociale për qytetare në kuadër të sektorëve për shërbime publike dhe sektorit për emergjencë në Drejtorinë për Shërbimeve publike. Kjo drejtori ka për qëllimin arritjen e objektivave dhe aktiviteteve të shërbimeve publike, në tërë territorin e Komunës së Skenderajt. DSHP-ja ka të ndara shërbimet në dy njësi (sektorë) themelore, ku secila ka detyrat dhe përgjegjësit e saj.

Sektori i Shërbimeve Publike:

Detyrat e Planifikuara	Komente	Periudha e planifikimit
Mbikëqyrë punët e ndërmarrjes publike;	Mbështetje Logjistike	Janar - Dhjetor

NPL Eko Natyra Sh.A Skenderaj					Janar - Dhjetor
Rregullim e trafikut dhe transportit urban;					
Eliminimi i Deponimeve ilegale në territorin e Komunës së Skenderajt	Mbështetje Logjistike				Mars - Tetor
Shtirja e Shërbimit nga KRM-Uniteti në territorin e komunës së Skenderajt	Fushat Vetëdijesime				Janar - Qershor
Mirëmbajtja dhe sigurimi i Objekteve Komunale	Monitorimi nga Zyrtari				Janar - Dhjetor
Mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimi i rrugëve parqeve publike, drunjeve dekorativ dhe varrezave të dëshmoreve dhe të Qytetit, (larja, fshirja dhe spërkatja e rrugëve).	Mbikëqyrë punën e kompanisë lokale NPL “Eko Natyra Sh.A”				Janar - Dhjetor
Mirëmbajtja e ndriçimit publik	DSHP ne bashkëpunim më kompaninë NPL “Eko Natyra Sh.A				Janar – Dhjetor
Jep pëlqim për shfrytëzimin e hapësirave publike në përputhje me planet dhe rregulloret komunale.	DSHP-Zyrtari ligjore				Janar –Dhjetor
Mirëmbajtja e kamareve të hapësirave publike	Siguria e lëvizjes të qytetareve do të jetë me e madhe				Janar-Dhjetor
Gjelbërimi i qytetit- Lulet sezonale	Mbjellja e luleve				Mars - Qershor
Menaxhon dhe kujdeset për mirëmbajtjen e auto-parkingjeve publik	Mbikëqyrë punën e kompanisë lokale NPL “Eko Natyra Sh.A”				Janar-Dhjetor
Bashkëpunimi nder komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave komunale	DSHP- ne bashkëpunim me Komunitat e Regjionit				Janar-Dhjetor
Planifikimi i pikave statike për grumbullimin e mbeturinave ne qytet	DSHP				Prill-Nëntor
Rishikimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	PKMM 2022-2027				Qershor-Tetor

Hartimi i rregullores komunale për menaxhimin e hapësirave publike dhe parkingjet publike	DSHP Zyrtari ligjore	Maj-Shtator
Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit dhe rregullimin e pusefave.	DSHP- KRUM Skenderaj	Janar-Dhjetor
Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetareve	DSHP dhe Sektorët	Janar-Dhjetor

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim:

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave e nivelit Komunal, vënien e standardeve te kryerjes se punës lidhur me gatishmërinë civile dhe reagimit Emergjent ne territorin e vet dhe koordinimin e subjekteve relevant për reagim ne Situata Emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë.

Sektori e MSH planifikon qe te merr masa te nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe përcjellje aktivitete e subjekteve relevante te involvuara.

Tabela e planifikimit:

Periudha e planifikimit	Detyrat e planifikuara	Bartësi i realizimit te planit	Komente
Janar-Mars	-Zbatimi i ligjit mbi Fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Ligjit mbi Mbrojtjen nga zjarri, dhe Rregulloreve tjera për punët e Sektorit -Renditja, sistemimi dhe konkretizimi i detyrave të parapara me ligj dhe rregullore. -Ngritjen profesionale të punëtorëve dhe detyrat e parapara më planin e punës. -Planifikimi për veprime efektive emergjente: strehimi, evakuimi, informimi etj.	Drejtori, Shefi Pl. Emergjent Z .Emergjent ZAKE	Përdorimi i një setë masash te reja, teknike e teknologjike si dhe zbatimi i një strategjie te zhvillimit sa me bashkohorë të menaxhimit të emergjencave. Realizimi i këtij plani do të ndikoj pozitivisht në menaxhimin-preventiven e fatkeqësive natyrore si dhe ato teknologjike.

	<p>-Vendosja e pajisjeve për ZAKE dhe rregullimi i antenës për shpërndarje në Rezallë dhe Skenderaj.</p> <p>-Menaxhimi dhe planifikimi në situatë të krijuar eventuale emergjente.</p> <p>- Në pjesën e parë ti jepet prioritet drejtimit të inspektimit të objekteve publike me pajisje kundër zjarrit.</p>			
Prill- Qershor	<p>-Kordinimi i punës dhe bashkëpunimi me: Policia e Kosovës, Kryqin e Kuq dhe OJQ et.</p> <p>-Vizita reciproke me karakter pune në AME, komuna ,institucione, BL te komunës tonë.</p> <p>-Organizimi në punët e Planeve Emergjente</p> <p>-Organizimi në përgatitjen e personelit për kryerjen e punëve në planifikim.</p> <p>-Në pjesën e dytë do te inspektohen objektet elektroenergjiqe, objektet e ujësjellësit, objektet industriale, objektet shëndetësorë, farmaceutike, depot e karburanteve etj.</p>	Drejtori, Shefi Pl. Em,dhe ZAKE Parandalimi nga FNFT	Angazhimi permanent i të gjithëve në realizimin e të gjitha detyrave te parapara dhe të planifikuara.	
Korrik- Shtator	<p>-Menaxhimi dhe planifikimi në situatë të krijuar eventuale emergjente.</p> <p>-Vendosja e lidhjeve horizontale me subjektet në komunë dhe BL përmes radio-lidhjeve dhe lidhjeve vertikale me QOER dhe komuna fqinje.</p> <p>-Trajnimet vjetore</p> <p>-Krijimi i Marrëveshjeve ndër komunalë te mirëkuptimit për Situata Emergjente.</p> <p>-Në pjesën e tretë do te behën inspektime në objektet dhe institucionet kulturore dhe objekteve arsimore.</p>	Drejtori, Shefi Pl. Emergjent Z për Emergjencia ZAKE Parandalimi nga FNFT	<p>Ngritja e vend strehimoreve është domosdoshmëri dhe shumë e nevojshme për strehimin e popullatës në raste eventuale emergjente qe mund të ndodhin në komunën tonë që mund të përdoren sallat sportive, shkollat etj.</p>	

Tetor-Dhjetor	<p>-Plotësimi me te dhëna tjera Planeve Emergjente</p> <p>-Përgatitja e Planit të Evakuimit për shkollat e mësimi dhe filloret e komunës sonë.</p> <p>-Angazhimi për sigurimin e vendstrehimeve në komunë.</p> <p>-Përgatitja e personelit për emergjencat në terren, BL, shkollat etj.</p> <p>-Evidentimi i pajisjeve të domosdoshme të ndërhyrjes për siguri civile sipas AME-së.</p> <p>-Organizimi eventuale i një ushtrimi rreth një Situate Emergjente në komunë..</p> <p>-Mbajtja e librit të dhënave dhe shënimeve tjera në ZAKE.</p> <p>-Inspektimi i pikave të karburanteve</p> <p>-Informimi dhe raportimi me kohë në rrafshin horizontal :BD,AK,KMSH dhe atë vertikal në AME për punët dhe aktivitetet tona të përhershme dhe për situatat emergjente (fatkeqësi eventuale).</p>	Drejtori; Shefi, PE,MC,ZA KE Parandalimi	Vërshimet e lumit Klina paraqesin rrezik permanent për shumë vendbanime të komunës sonë : Zona e epiqendrës L-3/L-6 në Skenderaj, Llaushë etj , dhe në propozojmë vazhdimisht të realizohet projekti për rregullimin e shtratit të lumit Klina dhe lumenjve tjerë në komunën tonë.
---------------	---	--	--

Projektet kapitale që do të realizohen gjatë vitit 2026 në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë:

Nr.	LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2026	Statusi	Periudha e planifikimit
1	Blerja dhe mirëmbajtja e kamerave të hapësirave publike	Vazhdim	2026
2	Riparimi dhe zgjerimi i vëndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre	Vazhdim	2026
3	Blerja e pajisjeve motorike për mirëmbajtjen e qytetit	I ri	2026
4.	Ndriçimi publik në Qytet dhe Bashkësitë Lokale	Vazhdim	2026
5.	Zgjerimi, pastrimi i lumenjve dhe largimi i dheut	I ri	2026

6.	Intervenimet dhe mirëmbajtja e kanalizimit	Vazhdim	2026
7.	Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve ne territorin e komunës se Skenderajit gjatë sezonit dimëror	I ri	2026
8.	Subvencionet	Vazhdim	2026

Drejtoria e Inspektoratit Komunal

Plani i punës i Drejtorisë së Inspektoriatit për vitin 2026 përcakton objektivat, prioritetet dhe aktivitetet kryesore për rritjen e zbatueshmërisë së ligjit në të gjitha sektorët. Ai bazohet në përvojën e viteve të mëparshme, nevojat e komunitetit dhe kërkesat ligjore të infrastrukturës inspektuese. Synohet forcimi i disiplinës, transparencës dhe mbrojtja e interesave të qytetarëve.

Objektivat kryesore që synojmë të arrijmë gjatë vitit janë:

1. Mbrojtja e konsumatorit,
2. Ruajtja e pronës publike,
3. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit,
4. Parandalimi i ndërtimit ilegal,
5. Transporti i sigurtë për udhëtarë.

Sektori i Tregut

Plani i punës në sektorin e tregut për vitin 2026 do të bazohet në ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që trajtojnë aspekte të ndryshme të këtij sektori. Ndërkohë, është e rëndësishme të theksohet se implementimi i këtyre aktiviteteve kërkon bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera dhe përpjekje për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve për t'u përballur me sfida të reja dhe me zhvillimet e shpejta në treg.

Objektivat kryesore për sektorin e tregut në planin e punës për vitin 2026 janë:

1. Rritja e ligjshmërisë në veprimtaritë tregtare;
2. Mbrojtja e konsumatorit;
3. Forcimi dhe promovimi i tregtisë formale;

4. Bashkëpunimi ndërinstitucional në zbatim të legjislacionit.

Sektori i Komunikacionit

Plani i punës në sektorin e komunikacionit për vitin 2026 do të bazohet në ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që trajtojnë aspekte të ndryshme në sektorin e komunikacionit.

Objektivat kryesore për sektorin e komunikacionit në planin e punës për vitin 2026:

1. Shtrirja e operatorëve të transportit të udhëtarëve në të gjitha zonat rurale;
2. Rritja e nivelit të sigurisë në transportin publik dhe rrugor.

Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Metodologjia e ndjekur për përpilimin e këtij plani merr në konsideratë ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit.

Objektivat kryesore për mbrojtjen e mjedisit në planin e punës për vitin 2026 janë:

1. Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave mjedisore dhe natyrore;
2. Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes mjedisore;
3. Zbatimi i legjislacionit dhe kushteve mjedisore;
4. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimeve publike mjedisore;
5. Rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për shkeljet mjedisore;
6. Ngritja e vetëdijes publike dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional.

Sektori i Shërbimeve Publike

Objektivat kryesore të planit të punës në sektorin e shërbimeve publike për vitin 2026 janë:

1. Parandalimi i uzurpimit të paligjshëm të pronës dhe hapësirave publike;
2. Monitorimi dhe parandalimi i kycjeve ilegale në rrjetin e kanalizimit;
3. Parandalimi i ndërhyrjeve pa leje në rrugë, trotuare dhe hapësira publike.

Sektori i Ndërtimit

Objektiva kryesore e planit të veprimit në sektorin e ndërtimit për vitin 2026:

1. Parandalimi i ndërtimit ilegal;
2. Mbikëqyrja e zbatimit të lejeve ndërtimore;
3. Kontrolli i përputhshmërisë së projekteve me standardet dhe rregulloret teknike.

Drejtoria Komunale e Arsimit

Ky plan përfshin aktivitetet kryesore të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Skenderajt për të gjitha nivelet e arsimit, sipas Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (SNKA): arsimin parashkollor dhe parafillor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.

Plani bazohet në zbatimin e politikave arsimore të MASHTI-t dhe prioriteteve të Komunës së Skenderajt, duke synuar përgatitjen e suksesshme të vitit shkollor, përmirësimin e kushteve infrastrukturore në shkolla, ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe forcimin e bashkëpunimit institucional me institucionet qendrore e lokale, prindërit, komunitetin, OJQ-të dhe organet e sigurisë.

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve- Përfshirja e mësimdhënësve në trajnime cilësore dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional, në përputhje me PSAK-un.

Objektivi Strategjik 2: Zbatimi i kurrikulës së re- Fuqizimi i kapaciteteve të shkollave për zbatim efektiv të kurrikulës së re dhe zhvillim të kompetencave të nxënësit.

Objektivi Strategjik 3: TIK-u dhe mjetet mësimore- Integrimi i TIK-ut në procesin mësimor përmes pajisjes së shkollave dhe aftësimit të mësimdhënësve.

Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë në arsim- Vendosija dhe funksionalizimi i mekanizmave për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë së arsimit.

Objektivi Strategjik 5: Infrastruktura fizike shkollore- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore, sigurisë dhe mirëmbajtjes së objekteve shkollore, përfshirë zgjerimin e arsimit parashkollor.

Objektivi Strategjik 6: Arsimi dhe aftësimi profesional- Harmonizimi i arsimit profesional me kërkësat e tregut të punës përmes bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet relevante.

Objektivi Strategjik 7: Orientimi në karrierë- Ofrimi i shërbimeve të orientimit në karrierë për nxënësit përmes politikave komunale dhe aktiviteteve vetëdijesuese.

Objektivi Strategjik 8: Mbështetja financiare për nxënësit dhe studentët- Ndarja e bursave për nxënësit të arsimit profesional dhe studentët të profiëve deficitare.

Rezultatet e pritshme:

Cijatë periudhës njëvjeçare, Drejtoria e Arsimit synon arrijten e këtyre rezultateve:


- Arrija e objektivave arsimore në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, në përputhje me planifikimet e MASHTI-t;
- Rritja e përfshirjes dhe bashkëpunimit të prindërve dhe komunitetit në mbështetje të procesit mësimor;
- Zbatimi i vlerësimit të brendshëm të performancës në të gjitha shkollat;
- Organizimi i trajnimeve për digjitalizim, përdorimin e tabelave interaktive, gjithëpërfshirjen dhe zbatimin e Kurrikulës së Re të Kosovës;
- Funkcionalizimi i rrjetit të koordinatorëve të cilësisë dhe trajnimit i tyre;
- Hartimi dhe zbatimi i Planit Komunal për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes së Shkollës, përfshirë koordinimin ndërmjet nivelit shkollor dhe atij komunal;
- Informimi i rregullt i Kuvendit Komunal për zhvillimet, sfidat dhe progresin e procesit edukativo-arsimor;
- Hartimi i Strategjisë Komunale të Arsimit për periudhën 2024–2028;
- Hartimi i Rregullores për subvencione në fushën e arsimit.

Vitin e ri shkollor 2025/26 e kanë filluar 8031 nxënësit; të grupuar në 474 paralele. Këta nxënësit vijojnë mësimet në institucionet arsimore të mëposhtme:

- 2 Institucion Parashkollor (1 IP në proces të hapjes);
- 24 Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta;
- 7 Paralele të ndara të Shkollave Filllore;
- 3 Shkolla të Mesme të Larta;

- 1 Klasë të bashkangjitur për fëmijë me nevoja të veçanta.

Tabela me numrin e nxënësve sipas niveleve shkollore:



Të dhënat e tjera, sipas klasave për nivele shkollore, mund t'i shihni në tabelarin emëposttëm

Klasa / Niveli	Mashkull	Femër	Gjithsej
Grupa 1-2	9	5	14
Grupa 2-3	12	7	19
Grupa 3-4	19	10	29
Grupa 4-5	19	11	30
Grupa 5-6 – Parashkollor (Çerdhe)	22	25	47
Gjithsej Parashkollorë (0-5 vjeç)	81	58	139
Gjithsej Parafillorë (Klasa përgatitore)	305	275	580
Klasa 1	278	285	563
Klasa 2	279	270	549

Klasa 3	315	309	624
Klasa 4	310	282	592
Klasa 5	341	325	666
Gjithsej Arsimi Fillor (Klasa 1-5)	1523	1471	2994
Klasa 6	323	279	602
Klasa 7	307	323	630
Klasa 8	323	310	633
Klasa 9	320	316	636
Gjithsej Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasa 6-9)	1273	1228	2501
Klasa 10	373	272	645
Klasa 11	334	296	630
Klasa 12	337	297	634
Gjithsej Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasa 10-12)	1044	865	1909
Gjithsej nxënës në të gjitha nivelet shkollore	4167	3864	8031

Aktivitetet e DKA-së në Skenderaj për vitin 2026

Aktivitetet	Koha e realizimit										Implementues		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor		Nëntor	Dhjetor
Përgatitja dhe shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve të klasave të para-arsimi fillor	✓			✓	✓								DKA Shkollat
Java e gjelbërimit për shkollat e komunës				✓									DKA Komuna
Vazhdimi i bashkëpunimit melidhjet e krijuara me drejtori komunale dhe shkolla të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin e Skenderaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓			✓	✓	✓	✓	DKA Shkollat
Përgatitja për kremtimin e "17 Shkurtit" – Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	✓	✓											DKA Shkollat
Epopeja e UÇK-së, 5,6 dhe 7 mars		✓	✓										DKA Shkollat
Takim përmbyllës me nxënës të dalluar, mësimdhënës dhe drejtorë. Përgatitja e mirënjohjeve dhe shpërblimeve modeste						✓							DKA Shkollat

Organizimi i garave në nivel komune me nxënës të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në lëndë shkencore									✓	✓										DKA Shkollat
Realizimi i trajnimit për zbatimin e KK-së											✓									DKA Shkollat
Bashkëpunimi me MASHTI-in	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA MASHTIT, SIA
Përgatitja për krenimin e ditës së fëmijëve "1 Qershor"																				DKA Çerdhet
Përgatitja e projekteve për rregullim të infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelëruara të shkollave															✓	✓	✓	✓	✓	DKA
Kompletimi dhe dërgim i të dhënave në MASHTI, me qëllim publikimi të konkursit për regjistrim të nxënësve në SHML (Shkollat e Mesme të Larta)										✓										DKA MASHT IT
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të larta															✓	✓	✓	✓	✓	DKA

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë (referuar në vijim si DGJKP) është përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale në formë digitale, modelin e sistemit informativ mbi pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese.

DGJKP procedon shfrytëzimin e pronave komunale, zbaton vendimet e gjykatave, aktet noteriale dhe aktet e tjera që dalin nga organe apo individë të licensuar nga organet shtetërore, që kanë të bëjnë më bartjen, bashkimin apo ndarjen e pronës.

Puna e Drejtorisë orientohet në atë mënyrë që, përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokave (SIKT) dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme mbi krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufijve të tyre brenda territorit të Komunës së Skenderajt.

1. Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe efikase në fushën e gjeodezisë, kadastrit dhe menaxhimit të pronës.
2. Organizon kapacitetet kadastrale në formë digjitale dhe menaxhon sistemin informativ mbi pronën.
3. Koordinon matjet kadastrale, regjistrat e pronave, dhe përcaktimin e kufijve të parcelave dhe ndërtesave.
4. Bashkëpunon me institucionet lokale, qendrore dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK).

Drejtoria ndahet në tre sektorë kryesorë:

1. Sektori i Gjeodezisë:

- Përpunon dhe regjistron të dhëna grafike.
- Identifikon ngastrat dhe njësitë kadastrale.
- Kryen ndarje dhe bashkim të ngastrave sipas kërkesës së palëve.
- Përditëson hartat dhe skicat e pronës.
- Ofron shërbime digjitale për koordinatat, kopjet e planit dhe lartësinë mbidetare.
- Bashkëpunon me AKK për rindërtimin e zonave kadastrale.

2. Sektori i Kadastrit:

Nr.	Objektivat	Procedura	Burimi	Mbikëqyrësi	Zbatuesi
1.	Shpronësimi	E rregullt	Legjislacioni në Fuqi Vendimi i Kuvendit Komunal	Kryetari i Komunës Kuvendi Komunal	DGJKP
2.	Verifikimi dhe procedimi për lirin e pronave të uzurpuara (nëse ka)	E rregullt	Legjislacioni në fuqi Vendimi i Organit Administrativ Komunal	Kryetari i Komunës DGJKP	DGJKP

3.	Inkasimi i të hyrave të qerasë dhe rentës	E rregullt	Legjislacioni në fuqi Rregullorja e brendshme e Komunës	Kryetari i Komunës DGJKP	DGJKP
4.	Arkivimi i dokumentacioni kadastral	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	DGJKP	DGJKP
5.	Mbikëqyrja e kontratave mbi shfrytëzimin e pronave publike	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Kryetari i Komunës Kuvendi Komunal	DGJKP
6.	Shërbime të tjera				

3. Sektori i Pronës:

Nr.	Objektivat	Procedura	Burimi	Mbikqyrësi	Zbatuesi
1.	Shpronësimi	E rregullt	Legjislacioni në Fuqi Vendimi i Kuvendit Komunal	Kryetari i Komunës Kuvendi Komunal	DGJKP
2.	Verifikimi dhe procedimi për lirim të pronave të uzurpuara (nëse ka)	E rregullt	Legjislacioni në fuqi Vendimi i Organit Administrativ Komunal	Kryetari i Komunës DGJKP	DGJKP
3.	Inkasimi i të hyrave të qerasë dhe rentës	E rregullt	Legjislacioni në fuqi Rregullorja e brendshme e Komunës	Kryetari i Komunës DGJKP	DGJKP
4.	Arkivimi i dokumentacioni kadastral	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	DGJKP	DGJKP

5.	Mbikëqytja e kontratave mbi shfrytëzimin e pronave publike	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Kryetari i Komunës Kuvendi Komunal	DGJKP
6.	Shërbime të tjera				

Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) operon përkohësisht nën Komunën e Skenderajt, por pritet të kalojë nën menaxhimin e AKK sipas Ligjit nr. 08/L-237.

Kryetari i Komunës



Sami Lushtaku